

Marrëveshja dypalëshe e Sigurimeve Shoqërore Itali-Shqipëri Mundësi të reja për daljet në pension

Dinjitet dhe të drejta të barabarta për 60 mijë punëtorët shqiptarë të sektorit të ndërtimit.

Një rezultat i rëndësishëm i arritur edhe falë mbështetjes së "Fillea", "Cgil" dhe "Inca". Me ratifikimin e Marrëveshjes për sigurimet shoqërore midis Italisë dhe Shqipërisë dhe njohjen reciproke të kontributeve të sigurimeve shoqërore të paguara në të dy vendet, dalja në pension lehtësohet jo vetëm për shtetasit shqiptarë në Itali dhe italianët në Shqipëri, por edhe për të gjithë ata që kanë punuar në të dy vendet.



Për shembull, për të dalë në pension, mund të shtoni periudhat e punës së kryer në Shqipëri për:

1. Arritjen e 20 viteve të kontributeve të nevojshme në rastin e pensionit të pleqërisë në Itali në moshën 67 vjeç.
2. Arritjen e kërkesave të kontributeve për forma të tjera të daljes në pension (*vjetërsi në punë, mundësi paradhënie për gratë, punë të rënda, punëtorët e hershëm...*).
3. Mundësi paradhënie të pensionit (Ape sociale), konkretisht me 32 vjet kontribute për punëtorët e ndërtimit dhe të guroveve me moshë të paktën 63 vjeç e 5 muajsh.

Me njohjen reciproke të kontributeve midis dy vendeve, ju gjithashtu mund të përdorni Fondin e Pensionit të Parakohshëm të ofruar nga "Cassa Edile" dhe të largoheni nga vendi i punës më herët, të paktën 4 vjet para se të arrini kërkesat për pension, sipas rasteve të ndryshme.



Së shpejti do të pasojë publikimi i formularëve nga "INPS", me të cilët mund të bëni aplikime në zyrat e patronazheve tona "Inca Cgil".

Për çdo informacion, kontaktoni zyrën më të afërt të "Fillea CGIL" ose "Patronato INCA CGIL"